

MBI KËPUJËN DHE KALLËZUESIN EMËROR NË GJUHËN SHQIPE

Leonard DAUTI
Resul TELHAJ

Përmbajtja e shkurtër: Folja këpujë në gjuhën shqipe ka qenë objekt i një këndvështrimi kryesisht sintaksor, por edhe nën këtë këndvështrim ajo është studiuar për atë që ka përcaktuar trajtimin e plotësisht predikativ të saj, i cili në mendimin gjuhësor shqiptar ka rezultuar si objekt i dy interpretimeve të ndryshme, të klasifikueshme si prani a) e kallëzuesit emëror dhe b) e kallëzuesorit. Çështja e pranimin a) e mospranimin të kallëzuesorit / kallëzuesit emëror është e lidhur ngushtë me statusin semantik dhe rolin organizues strukturor të foljes këpujë. Vetëm një analizë disaplanëshe e saj në gjuhën shqipe, e përkatësisht e lidhjeve dhe e funksioneve sintaksore, si dhe e kontributit strukturor të saj, mund të na ndihmojë edhe në mbajtjen e një qëndrimi më të argumentuar në lidhje me kundërvënien e mësipërme. Kjo përbën objektin e punimit tonë, në të cilin jemi munduar të analizojmë natyrën e marrëdhënieve sintaksore që realizon këpuja, si dhe ndërtimin strukturor të fjalisë këpujore.

Parashtrim

Si folje këpujë në "*Gramatika e gjuhës shqipe I*" (botim i Akademisë së Shkencave) është pranuar "ajo që shërben për të vënë në lidhje pjesën emërore (emër, mbiemër, përemër) të kallëzuesit me kryefjalën" (2002a:261). Si e tillë pranohet folja *jam*, së cilës i njihet një kuptim leksikor i zbehur (po aty). I njëjti qëndrim mbahet edhe në vëllimin e dytë të kësaj gramatike ("*Sintaksa*"), ku thuhet se "si këpujë përdoret folja *jam*, e cila në këtë përdorim ka kuptimin mjaft abstrakt të ekzistencës së një

karakteristike. Për këtë arsye funksioni i saj kryesor është të shprehë kallëzuesinë: mënyrën, kohën e vetën" (2002b:189).

Një qëndrim i ndryshëm ndaj foljeve këpujë shfaqet që herët në sintaksën e Justin Rrotës (1941) dhe, para tij, në atë të Ilia Dilo Sheperit (1927), i cili njeh si të tilla edhe *gjendem, bëhem, lind, dal, mbetem, rri, rroj, dukem, dëfthem, tregohem, kuptohem, gjykohe, quhem, emërohem, thuhem, zgjidhem* etj. Në mbështetje të një mendimi të tillë vijnë edhe R. Përnaska (1973) e M. Çeliku (2012). Nga ana tjetër, K. Cipoja (1952), S. Prifti (1963), M. Domi (1970) dhe M. Totoni (1987) njohin vetëm foljen *jam* si këpujë në gjuhën shqipe.

Një çështje e lidhur ngushtë me statusin semantiko-strukturor të këpujës është ajo e kallëzuesit emëror. Cilësimi "pjesë emërore e kallëzuesit" në gramatikën e cituar më lart e nënkupton të mirëqenë pranimin e kallëzuesit emëror në të gjitha rastet kur shfaqet folja këpujë *jam*: "Kallëzuesi emëror formohet prej dy pjesësh, prej këpujës dhe prej gjymtyrës emërore. Të dyja këto pjesë formojnë një të tërë të vetme, ku kuptimi gramatikor dhe kuptimi leksikor shprehen prej dy fjalësh vërtet të ndryshme, po të lidhura ngushtë midis tyre" (2002/b:189). Kallëzuesi emëror pranohet edhe në rastin e foljeve të tjera të para si këpujë, madje edhe kur lidhja e shënuar prej këpujës është ajo midis pjesës emërore të kallëzuesit dhe kundrinorit (M. Çeliku, 2012:156). Kundër pranimin të kallëzuesit emëror qëndron teza e mosnjohjes së tij (R. Memushaj, 2009; Th. Dhima, 2010), edhe për rastet kur pjesa emërore që pason këpujën *jam* lidhet me kryefjalën.

Nga kjo tërësi e kundërshti këndvështrimesh burojnë një sërë pyetjesh, si:

Cilat janë foljet këpujë në gjuhën shqipe dhe mbi bazën e cilave kritere do të përcaktohen ato? Cila është natyra e lidhjeve sintaksore që përmbush këpuja "jam" dhe a realizojnë të njëjtat lidhje edhe "foljet e tjera këpujore" në gjuhën shqipe? A gëzon të njëjtin status bërthama predikative e foljes *jam* me atë të krijuar prej foljeve të tjera këpujore, në organizimin strukturor e semantik të fjalisë?

Përgjigja këtyre pyetjeve nënkupton një pasqyrim të marrëdhënieve që ndërmjetëson këpuja midis dy grupeve emërore në fjalinë e shkurtër, si dhe një analizë e hollësishme e organizimit strukturor të fjalisë këpujore. Lidhur me pyetjen e fundit mbetet për t'u sqaruar edhe pranimi a mospranimi i kallëzuesit emëror ose i përcaktorit kallëzuesor. Shtjellimin e çështjeve të sipërpërmendura jemi përpjekur ta bëjmë në përputhje me arritjet më të fundit të mendimit gjuhësor në lidhje me këpujën dhe me organizimin

strukturor të fjalisë së shkurtër këpujore, parë nën këndvështrimin gjenerativist e konjitivist. Kjo do të thotë se në këtë punim nuk jemi përpjekur të mbajmë një qëndrim të caktuar lidhur me trajtimin e deritanishëm të këpujës dhe të fjalive këpujore në gjuhën shqipe, por të analizojmë aspekte të tyre nën një këndvështrim më të gjerë, për të hedhur dritë mbi çështje të lëna në hije ose të pandriçuarra sa duhet.

Roli semantik e strukturor i foljeve këpujore

Folja këpujë ka qenë në qendër të shqyrtimit gjuhësor për një kohë relativisht të gjatë dhe vijon të përbëjë një objekt interesant studimi për vetë larminë e vështirësinë e problematikës që ngërthen. Ndër autorët kryesorë që janë marrë me të mund të përmendim Benveniste (1950), Lyons (1968, 1977), Dik (1980, 1983). Më 1906 Antoine Meillet paraqet atë që njihet si "Dummy Hypothesis", ideja qendrore e së cilës "është konceptimi i këpujës si një element i zbrazët semantikisht", si një "morfemë lidhëse abstrakte", e cila është e çliruar nga kuptimi leksikor 'i pavarur' (Dik, 1989:56). Kjo do të thotë që në gjuhët ku shfaqet një këpujë e plotë, ky element mendohet se ka një funksion të pastër gramatikor (Stassen, 1997:65). Kështu, Lyons-i i njeh këpujës rolin e një "lokusi" (element i strukturës sipërfaqësore, që është bartës i një tipari dallues sintaksor) për shenjimin e kohës - mënyrës - aspektit në rasishte, greqishte, latinishte (2001:300). Përtej interpretimeve e rishikimeve të ndryshme të "Dummy Hypothesis", ideja bazë e saj mbetet se "këpuja në thelb është një 'hat-rack' (mbartëse - *shën. ynë*) për kategoritë morfologjike të foljes" (Stassen, 1997:66).

Mungesa e këpujës në disa gjuhë, si rasishtja etj., mund të merret si argument në të mirë të boshllëkut semantik të saj. Në gjuhën shqipe këpuja është e detyrueshme. Mendimi mbi mungesën e këpujës në gjuhën shqipe (Totoni, 1978:70-71) nuk ka pasur jehonë e për pasojë as përkrahës të tjerë dhe nuk është bërë objekt i debatit gjuhësor. Interpretimi i rasteve me mungesë të këpujës në gjuhën shqipe lidhet me dukurinë e elipsës (Prifti, 1986:146) dhe jo me veçorinë e saj për të gjeneruar struktura sintaksore me këpujë zero. Shfaqja e rëndomtë e elipsës në ndërtimet këpujore (*po aty*, 148), sidomos në gjuhën e folur, veçanërisht në fjalët e urta a proverbat, mund të jetë lehtësuar pikërisht nga mungesa e barrës semantike të saj.

Një tjetër interpretim i rolit semantik të këpujës është ai, sipas të cilit "këpuja është semantikisht e zbrazët dhe prandaj nuk mund të përcaktojë

rolet- θ^1 " (Lohndal, 2006:39). Përcaktimi i roleve-9 është karakteristikë e foljeve të zakonshme (të plota) e në lidhje me këtë aftësi të tyre mbizotëron ideja se përcaktimi i roleve *theta* i dedikohet krejt grupit foljor VP dhe jo vetëm foljes (Marantz, 1984; Chomsky, 1986; Radford, 2004; Hornstein, Nunes and Grohmann, 2005). Kriteri mbi përcaktimin e roleve- θ është ky: *Nëse një kallëzues karakterizohet nga n tipare semantike, ai duhet të ketë përkatësisht n argumente.*

Duke qenë se këpuja nuk del e përdorur në një strukturë tematike, do të thotë se nuk kemi prani të roleve *theta*, gjë e përcaktueshme nga zbrazëtia semantike e saj.

Sipas Lohndal-it, pranohet që fjalia kërkon një kallëzues me përmbajtje leksikore, kusht të cilin nuk mund ta përmbushë vetë këpuja. Gjithashtu fjalia duhet të plotësohet edhe me një kryefjalë (2006:40). Në mendimin gjuhësor shqiptar mëtohet që boshllëku semantik i këpujës të plotësohet prej pranisë së gjymtyrës emërore si pjesë përbërëse e predikatit. Është pranuar se ajo (*këpuja*) "shërben për të lidhur kryefjalën me plotësoarin, i cili e plotëson semantikisht këpujën (*këpuja*, duke qenë e desemantizuar, kërkon të plotësohet semantikisht nga një pjesë çfarëdo e ligjëratës)" (Çeliku, 2012:155). Nevoja për "plotësim semantik" duhet të shprehet në rolin që luan këpuja për organizimin strukturor të fjalisë.

¹ Rolet *theta* janë objekt i "teorisë *theta*", e cila si pjesë e gramatikës universale merret me përmbushjen e valencës së foljes. Qëllimi i kësaj teorie është të përcaktojë se cilat NP mund të jenë argument i foljes, si dhe të përcaktojë lidhjet semantike midis përbërësve në një strukturë. Sipas Radford-it (1988) teoria *theta* është një modul i gramatikës universale, sipas së cilës janë marrëdhëniet tematike ato që lidhin argumentet në një strukturë. Sipas kësaj teorie çdo argument merr një rol semantik të njohur si *rol-theta*. Një *rol-theta* përfaqëson marrëdhënien semantike të argumentit me kallëzuesin. Ndër rolet *theta* mund të përmendim: *vepruesi* (ai që kryen veprimin, zakonisht kryefjala e fjalisë), *përjetuesi* (argumenti që përjeton një veprim ose një gjendje psikologjike), *tema / pësuesi* (njësia mbi të cilën bie veprimi), *synimi* (njësia drejt së cilës lëviz diçka), *marrësi* (shfaqet vetëm me folje, të cilat shënojnë ndryshim pronësie), *burimi* (njësia nga nis veprimi), *vendi* (vendi ku zhvillohet veprimi), *mjeti* (njësia me të cilën kryhet diçka), *përfituesi* (ai të cilin i jepet diçka ose që i ndodh diçka e mirë), *zotëruesi* (ai që zotëron diçka), *i perceptuari* (diçka ose dikush që perceptohet). Shpërndarja e këtyre roleve përcaktohet nga dy parime kryesore: a) Kriteri *theta*; b) parimi i projektimit. Duke u bazuar te Chomsky (1981), kriteri *theta* mund të përkufizohet kështu: *çdo argument mbart një dhe vetëm një rol- θ dhe çdo rol- θ i përket një dhe vetëm një argumenti.* Parimi i projektimit kërkon që përfaqësimet në çdo nivel sintaksor duhet të projektohen nga leksiku, në mënyrë që të vrojtojnë tiparet leksikore të njësisë që përmbajnë. Kjo do të thotë që një folje, e cila merr si kryefjalë veprues, nuk mund të marrë një kryefjalë temë ose synim, ndërsa foljet që kanë një kryefjalë jotematike nuk mund të bëhen pjesë e një strukture, subjekti i së cilës ka fituar një *rol- θ* .

Analiza strukturore e shembujve që ofron gjuha shqipe, siç e kemi parqitur edhe në paragrafët pasues, dëshmon se zgjedhja e kryefjalës nuk është proces që merret përsipër prej këpujës. Në fjalitë këpujore është pikërisht argumenti i brendshëm përgjegjës për zgjedhjen e subjektit, që do të thotë se elementi paskëpujor (XP2) vendos se cili element mund të dalë në rolin e kryefjalës (XP1).

(1) a. Mali është i lartë. / *Shiu është i lartë.

b. Deti është blu. / *Dëgjimi është blu.

Në rastet e mësipërme kryefjalën e përcakton mbiemri (*i lartë, blu*), i cili del në rolin XP2. Këpuja nuk luan ndonjë rol në këtë përzgjedhje, duke dëshmuar se tek ajo nuk ka ndodhur procesi i plotësimit semantik. Fjalja këpujore është e strukturuar pa u vërtetuar semantizimi i këpujës. Kjo e vë në pikëpyetje konstatimin e mësipërm në lidhje me nevojën e saj për plotësim semantik. Realizimi i bërthamës predikative të fjalisë nuk mund të shpjegohet në bazë të nevojës së këpujës për t'u plotësuar semantikisht, rezultat i së cilës është bashkimi i saj me XP2. Në parashtrim idenë se nuk është këpuja ajo që bashkohet me XP2 për t'u plotësuar semantikisht, por është pikërisht XP2, sintagma paskëpujore, ajo që kërkon të fitojë predikativitet duke u bashkuar me këpujën e natyrisht përmbush në këtë mënyrë aftësinë për të përcaktuar kryefjalën, duke u identifikuar si kallëzues i fjalisë.

Ekzistenca e fjalive pavetore në gjuhën shqipe, të ndërtuara me foljen *jam* në vetën e tretë, është një argument që tregon se është pikërisht sintagma XP2 ajo që ka aftësinë për të përcaktuar ose jo kryefjalën.

(2) a. Është natë.

b. *Ajo është natë.

Në fjali të tilla lidhja e foljes *jam* me plotësin nuk kërkon domoshmërisht një sintagmë XP1 të shprehur fonetikisht. Ndryshe ndodh në anglishte ku vendi i kryefjalës mbushet nga përemri asemantik *it*.


(3) a. It is night.

b. It is hot.

Kjo do të thotë se semantikisht në lidhjen *këpujë + XP2* këpuja është në rolin e komplementit, ndërsa elementi që e pason atë, i cili tradicionalisht njihet si plotës i saj, del në rolin e kokës, pasi ai është predikati semantik.

Struktura sintaksore në të cilën shfaqet këpuja është $XP1 + këpujë + XP2$, e cila përfaqëson fjalinë e shkurtër këpujore. Ne do të mbështetemi në strukturën bazë predikative (4/a), sipas propozimit të Mikkelsen (2005: 167), prej së cilës gjenerohet struktura e fjalisë këpujore (4/b), e paraqitur prej Hazaut (2004:411):

Sipas kësaj skeme në pozicionin e specifikuesit del një argument referencial, ndërsa si plotës një argument predikativ (Lohndal, 2006:53), joreferencial.



Sipas Mikkelsen-it këpuja bëhet pjesë e sintagmës foljore VP mbi pozicionin funksional PredP. Pra, në VP bëhet kalimi nga struktura e shkurtër në një strukturë të plotë predikative. Në këtë nivel plotësohet fjalia me adjunktë kohorë, mënyrorë e vendorë ose me modifikues ndajfoljorë. Një interpretim i tillë kërkon paraprakisht sqarimin e pozicionit *Pred* në skemën e mësipërme. Duke u nisur nga përcaktimi mbi foljen, sipas të cilit "X është folje në qoftë se dhe vetëm në qoftë se X është një kategori leksikore dhe X ka një specifikues" (Baker, 2003:23), është motivuar nevoja për kategorinë funksionale *Pred*: "[...] vetëm foljet janë predikat i vërtetë, me aftësinë të përcaktojnë një specifikues, të cilit zakonisht i ngarkojnë një rol *theta*. Në të kundërt, emrat dhe mbiemrat kërkojnë ndihmë nga një kategori funksionale *Pred* për ta realizuar këtë" (Baker, 2003:20-21).

Nga skema (4/a) lihet të kuptohet se *Pred* luan rolin e një elementi lidhës, i cili ndërmjetëson marrëdhënien predikative. Ne do të bazohemi në interpretimin sipas të cilit, ky element "[...] në strukturën e marrëdhënies predikative është një kokë funksionale *abstrakte* - jo një kategori e re leksikore, as element funksional (si T a D), por një vend mbajtës për *ndo-*

një kokë funksionale në strukturë, që ndërmjetëson një lidhje predikative midis dy njësive" (Den Dikken, 2006:15).

Sipas këtij interpretimi tashmë bëhet e qartë ideja e cituar më lart e Mikkelsen-it, sipas së cilës këpuja i bashkohet strukturës në pozicionin *V* të skemës (4/b). Lidhja midis DP në rolin XPref dhe (AP, NP, DP, PP, VP,) në rolin XPpred është një lidhje predikative, ku XP2 është predikati, pasi është pikërisht ai që përcakton njësinë leksiko-gramatikore që del në pozicionin XP1. Që kjo lidhje të funksionojë si një strukturë sintaksore e pavarur ka nevojë për kokën foljore, e cila përftohet në një nivel mbi PredP, përmes marrjes së këpujës në pozicionin *V*. Përmes këpujës sintagma predikative fiton kategoritë MKA, të domosdoshme për bërthamën predikative të fjalisë, si dhe aftësinë për t'u zgjeruar me plotës a modifikues të tjerë.

Parashtrimi i mësipërm na ndihmon për të sqaruar edhe qëndrimin e mbajtur në gramatikat tona në lidhje me interpretimin e fjalisë këpujore në gjuhën shqipe, si e lindur prej shpërbërjes së grupit emëror / sintagmës emërore (Totoni, 1978:71; Dhima, 2010:125). Pranimi i një hipoteze të tillë ndesh në disa vështirësi, të cilat burojnë nga zbatimi i rregullës së bashkimit dhe të lëvizjes (*merge and move*) së pjesëve brenda strukturës sintaksore. Së pari, prej të dy autorëve të mësipërm nuk sqarohet nëse emri në pozicionin kokë është i shquar apo i pashquar. Pra, bëhet fjalë për një NP, apo DP? Nga shembulli *natë pa hënë* (Dhima, 2010:125) lihet të kuptohet se pikënisja është një NP. Së dyti, nuk përcaktohet natyra e marrëdhënies midis kokës dhe komplementit të NP. Ne mund të krahasojmë një fjali këpujore me sintagmën emërore (NP), prej së cilës supozohet se ajo është përftuar.

(5) a. Mal i lartë


b. Mali është i lartë.

Në [NP mal i lartë] komplementi i lartë shënjon një tipar dallues-veçues, që shërben për të dalluar një tip ose grup të caktuar brenda të njëjtit lloj: mal i zhveshur, mal gri. Në rastin e fjalisë këpujore (5/b) tipari i shënjuar nga i njëjti mbiemër shërben si tipar atributiv-identifikues i llojit të qenët i lartë. Nga përjasja krahasuese e dy ndërtimeve të mësipërme lindin një sërë pyetjesh, të cilat vështirë se mund të marrin një përgjigje që të kënaqë hipotezën e mësipërme: A mund të shpjegohet kalimi nga raporti përcaktor në raport identifikues falë pranisë së bërthamës predikative, e cila krijohet përmes bashkimit të XP2 me këpujën? Si ndodh procesi i

shpërbërjes së sintagmës emërore dhe kalimi i saj në fjali këpujore? Më saktë, si mund të lëvizë koka emërore e NP në (6/a) drejt pozicionit Spec. në (6/b)? Në qoftë se nisemi nga sintagma bazë [NP mal i lartë], si mund të shpjegohen lëvizjet e pjesëve përbërëse të saj falë bashkimit me foljen këpujë?

Si për rastin e gjuhës shqipe, ashtu edhe për gjuhë të tjera, ne nuk kemi të dhëna të mjaftueshme që të vërtetojnë se këpuja përcakton natyrën e lidhjes semantike midis dy grupeve emërore. Në aspektin strukturor, çështja kryesore që mbetet për t'u sqaruar është se si emri lë vendin e kokës së sintagmës emërore dhe shkon drejt pozicionit të specifikuesit në sintagmën foljore. Lëvizja e emrit nga pozicioni kokë në pozicion specifikuesi thyen rregullën e lëvizjes së elementeve brenda strukturës së fjalisë. Drejt këtij pozicioni mund të lëvizë një sintagmë dhe jo një përbërës i saj (Koleci & Turano, 2011:60). Po kështu, mbetet për t'u sqaruar se në cilin nivel e fiton shquarsinë emri në pozicionin XP1, duke qenë se si kokë e sintagmës emërore ai është i pashquar.

Edhe në qoftë se NP do ta zëvendësojmë me një DP, përfundimi është i njëjtë, pasi lëvizja nga pozicioni kokë në pozicionin e specifikuesit nuk mund të justifikohet.




Një tjetër kundërgargument ndaj tezës se baza strukturore e fjalisë këpujore predikative është grupi emëror, është edhe prania e ndërtimeve të tilla, të cilat nuk mund të lidhen detyrimisht me ekzistencën paraprake të një sintagme bazë.

- (7) a. Teuta është mësuese.
 c. Mira është më e zgjuara e klasës.
 d. Vera është stina më e nxehtë.

Për mendimin tonë dy ndërtimet e paraqitura në (5) janë të pavarura nga njëra -tjetra:

[NP NP [N' N AP]] ≠ [PredP NP [Pred' Pred AP]]



Kjo do të thotë që sintagma predikative shfaqet si strukturë e veçantë dhe ngjashmëria e saj me NP është e natyrës sipërfaqësore. Ajo bazohet në daljen e XPpred në rolin e kokës semantike dhe të DP në rolin e specifikuesit XPref. Në gjuhën shqipe ky tip ndërtimi ndeshet në gjuhën e folur: *i kripur djathi, i ngrohtë dielli, i lezetshëm ky tipi, "E shtrenjtë kripa në Durrës ... "* etj. Interpretimi i tyre nuk mund të bëhet në bazë të NP/DP ose AP, por në bazë të PredP (4/a). Marrëdhënia midis dy gjymtyrëve është atributive - identifikuese dhe jo përcaktore. Në këto sintagma emri (DP) del në rolin e specifikuesit dhe jo të kokës a të komplementit, pozicion të cilin ia përcakton mbiemri, që del në rolin XPpred. Prania e njësisë *Pred* shpjegon natyrën e veçantë të marrëdhënies midis dy grupeve XP1 dhe XP2. Edhe lëvizja nga e djathta në të majtë e XPref është në përputhje me kriteret e *merge and move*.

Zbrazëtia semantike e këpujës është një dukuri që shoqërohet nga lidhje të caktuara sintaksore që vendosen brenda fjalisë midis dy grupeve emërore, ku zakonisht i dyti (XP2) është plotës i të parit (XP1). Ndërsa foljet e plota (semantikisht) shënjojnë një veprim a gjendje (zakonisht të kryefjalës, por edhe të gjymtyrëve të tjera), folja këpujë shënjon lidhjen mes grupit emëror, i cili luan zakonisht rolin e kryefjalës dhe të grupit emëror që hyn në marrëdhënie predikative atributive ose identifikuese me të. Folja *jam* në një funksion të tillë, përmbush funksione të mirëfillta gramatikore, siç është realizimi i predikativitetit të fjalisë përmes kategorive të *mënyrës - kohës - aspektit* (MKA).

Në gjuhën shqipe bëhet dallimi midis *jam* si folje e plotë dhe *jam* si këpujë. Përveç funksionimit si folje këpujë, ajo del si folje me kuptim të plotë, në të gjitha ato raste kur mbart kuptimin e ekzistencës (9/a-b) dhe mund të zëvendësohet prej foljes *ndodhem*. Një karakteristikë e tillë e afron këpujën e shqipes me atë të greqishtes *είμαι* (Lyons, 2001:361), për të cilën është i zakonshëm përdorimi i tipit (9/b). Është pikërisht kuptimi i ekzistencës që lidhet me rrethanën vend, kohë, mënyrë etj. Prandaj edhe në fjalitë kur *jam* është folje e plotë (jo e desemantizuar) lidhjet rrethanore janë një dukuri e natyrshme. Folja *jam* del si kallëzues foljor (*folje e plotë*) në të gjitha ato raste kur mund të shoqërohet me një ndajfolje vendi ose me një rrethanor vendi (Cipo, 1952:5). Praktikisht, mundësia e zëvendësimit ose jo përmes foljes *ndodhem* mund të shërbejë si kriter dallues midis këpujës dhe foljes së plotë *jam*.

(9) a. E di se kush është në atë helikopter? - tha përgjegjësi. (*Xhaferi, 2010/2:269*).

b. Po Pinesi është? - pyeti Ergysi.

Pinesi është, - tha roja. (*Xhaferi, 2010/2:119*).

Lidhur me semantikën e foljes këpujë mendimet e shfaqura prej autorëve shqiptarë nuk përputhen plotësisht. Është pranuar që folja *jam* në përdorimin e saj këpujor "ka kuptimin mjaft abstrakt të ekzistencës së një karakteristike" (Totoni, 1978:70), ose se ajo "mund të jetë e desemantizuar plotësisht a pjesërisht (çka varet nga vetë folja-këpujë e nga shkalla e përdorimit të saj në gjuhë)" (Çeliku, 2012:155).

(10) a. Elbasani është në qendër të Shqipërisë.

b. Elbasani është qendra e Shqipërisë.

Në (10/a) *është* del si folje e plotë, pasi ka kuptimin e ekzistencës dhe mund të zëvendësohet prej *ndodhet*. Në (10/b) kuptimi i ekzistencës nuk dëshmohet, pra, folja është desemantizuar dhe e aftë, kështu, për të shërbyer si këpujë. Një analizë e mëtejshme e natyrës së lidhjes mes dy grupeve emërore që shënon këpuja, e sqaron më mirë karakterin e saj. Përgjithësisht pranohet se këpuja nuk shpreh praninë e një tipari të kryefjalës, por një raport identifikues midis kryefjalës dhe plotësorit. Në një fjali ku dalin grupi emëror në rolin e kryefjalës dhe grupi emëror në rolin e plotësorit, këpuja *jam* vendos një lidhje identifikuese mes të dytit dhe të parit. Ndërmjet dy grupeve emërore *Shqipëria* dhe *republika* këpuja vendos lidhjen identifikuese, ku *republika* shërben si tipar identifikues i *Shqipëria*, i dallueshëm nga *monarki*, *republika presidenciale* etj.

(11) Shqipëria është republikë.

Në rastin kur në rolin e plotësit të foljes *jam* del një grup emëror, aq më pak në rastin e daljes së një grupi mbiemëror, nuk mund të bëhet fjalë për praninë e një kuptimi abstrakt të ekzistencës.

Nisur nga parashtrimi e argumentimi i deritanishëm, mund të përcaktojmë kriteret që duhet të përmbushë një folje për t'u vlerësuar si këpujë: a) Folja duhet të jetë e desemantizuar, çka shprehet në pamundësinë e zëvendësimit të saj prej *ndodhem*, *gjendem*. b) Folja në fjalitë predikative mund të hyjë në lidhje me pjesë të tjera të fjalisë vetëm si pjesë e kallëzuesit emëror dhe kurrë e mëvetësishme. Nëse fjalia mund të zgjerohet me sintagma të tjera, të afta për të hyrë në lidhje të drejtpërdrejtë me foljen, duke shmangur pjesën emërore të kallëzuesit, folja nuk mund të konsiderohet si këpujë.

Në bazë të një vlerësimi të tillë statusin e këpujës në gjuhën shqipe, sipas gjykimit tone, e gëzon vetëm folja *jam*.

Foljet e tjera, si *bëj*, *ndodhem*, *gjendem*, *dal*, *bëhem*, *lind*, *mbetem*, *rri*, *rroj*, *dukem*, *tregohem*, *emërohem*, *gjykohe*, *zgjidhem*, *kam*, *emëroj*, *shpall*, *quhem*, *thuhem* etj., afrojnë me këpujën për sa u përket lidhjeve sintaksore, por dallojnë prej saj për shkak të pavarësisë së tyre kuptimore, pavarësi e cila u siguron atyre rolin e kallëzuesit foljor të pavarur brenda fjalisë.

0.2 Folja këpujë dhe kallëzuesi emëror

Prania e kallëzuesit emëror në gjuhën shqipe lidhet me këpujën *jam* (Totoni, 1978:70; A Sh., 2002a:261), por edhe me folje të tjera të trajtuara si këpujë (Sheperi, 1927:142; Çeliku, Karapinjalli & Stringa, 1998:126; Çeliku, 2012:156). Duke qenë se edhe ne njohim si folje këpujë vetëm *jam*, do të pranojmë si kallëzues emëror vetëm emrin a sintagmën emërore që e pason atë dhe krijon lidhje dyfishe, me kryefjalën dhe me këpujën.

Në gjuhën shqipe, sipas studimeve të deritanishme mbi kallëzuesin emëror (Totoni, 1978; A Sh., 2002b; Çeliku, 2012), sintagmat që dalin në rolin e XP janë: XP_{pref} = {DP} / XP_{pred} = {AP, NP, DP, PP, VP}, të cilat ne po i ilustrojmë me shembujt e mëposhtëm:

- (12) a. Koha ishte e freskët. Dhoma ishte e vogël. (AP)
 b. Besimi ishte maturant. Margarita është mësuese. (NP)
 c. Ky libër ka qenë i Besimit. (NP)
 d. Ajo është puna jonë. (DP)
 e. Kjo s'ishte për fajin tim. (PP)
 f. Besimi ishte i dashuruar. (AP)
 g. Syzet ishin për të parë afër. (VP)

Pyetja më e natyrshme që mund të lindë nga paraqitja e këtyre shembujve është: Ku mbështetet emërtimi "kallëzues emëror", kur në një funksion të tillë dalin edhe mbiemra a folje?

Ndër shembujt e mësipërm vlen të ndalemi te (12/c). Në rolin e kallëzuesit emëror pranohet dalja e emrit në rasën gjinore (Totoni, 1978: 72; A. Sh., 2002:191; Çeliku, 2012:158). Marrëdhënia e emrit në gjinore me emrin me të cilin lidhet është marrëdhënie përkatësie dhe jo atributive, që është baza e marrëdhënies predikative mes XP2 dhe XP1. Interpretimi më i saktë i këtij ndërtimi duhet bërë në bazë të pranimit të elipsës. Ndërtimi i plotë duhej të ishte: *Ky libër ka qenë [Ø libri] i Besimit*. Objekt i elipsës është koka e sintagmës emërore. Shkaku i veprimit të elipsës duhet kërkuar te përsëritja e të njëjtit emër (*libër - libri*), ose dalja e një hiperonimi (*mall, pronë*) si kokë e sintagmës emërore në rolin e kallëzuesit emëror. Në mungesë të emrit-kokë nyja e gjinore përshtatet me gjininë e emrit në rolin e kryefjalës. Në rastin kur emri nuk është i pranishëm në sintagmën XP1, dalja e tij në XP2 është e detyrueshme.

(13) Ky është libri i Besimit.

Një dukuri të tillë e konstaton së pari Cipoja, i cili e trajton emrin në gjinore si *plotës i të përkulturit* (Cipo, 1952:68). Mospraninë e emrit ai nuk e lidh me dukurinë e përsëritjes, por me mungesën e një emri të tipit *pronë, mall* për rastin "*Kjo makinë është e një shoku*" (po aty). Duke u pajtuar me një interpretim të tillë, këtë rast do ta trajtojmë si rast të pranisë së *kallëzuesit emëror eliptik*. Një interpretim i tillë është i vlefshëm edhe për rastet (12/a, e, f, g), ku si rezultat i veprimit të elipsës kallëzuesi emëror shfaqet si PP, AP, VP.

(14) a. Koha ishte [Ø kohë] e freskët. Dhoma ishte [Ø dhomë] e vogël. (NP)

b. Kjo s'ishte [Øndodhi] për fajin tim. (NP)

c. Besimi ishte [Ø djalë] i dashuruar. (NP)

d. Syzet ishin [Ø syze] për të parë afër. (NP)

e. Busti është [Ø bust] prej bronzi. (NP)

Fjalitë janë të interpretueshme si fjali këpujore me *kallëzues emëror eliptik*, duke qenë se elipsa vepron në kokën e sintagmës emërore në pozicionin XP2. I vetmi rast kur fjalia këpujore shfaqet si eliptike është ai i përdorimit të tyre në dialogë të ndërtuar në formën pyetje - përgjigje. Në këto raste elipsa vepron mbi krejt grupin emëror që del në rolin e kallëzuesit emëror:

(15) - Kush është studenti më i mirë i grupit?

- Antoneta është [Ø studentja më e mirë e grupit].

Siç shihet nga rindërtimi i plotë i fjalive këpujore, në rolin e kallëzuesit të fjalisë del një emër ose një sintagmë emërore, gjë që shpjegon përdorimin e termit *kallëzues emëror*.

Një përfundim i tillë përputhet edhe me interpretimin e Gramatikës së Akademisë së Shkencave I (*Morfologjia*), sipas së cilës në rolin e kallëzuesit emëror del vetëm emri në rasën emërore, ndërsa ai në gjinore mund të dalë në rolin e përcaktorit kallëzuesor, rast në të cilin ai përfaqëson një togfjalësh të nënkuptuar (A. Sh., 2002a:109)².

Pranimi i elipsës në sintagmën e kallëzuesit emëror shërben edhe si një argument në të mirë të idesë që ne kemi parashtruar në § 0.1, se baza e fjalisë këpujore nuk mund të jetë shpërbërja dhe rikompozimi i grupit emëror. Struktura bazë e fjalisë së shkurtër këpujore është: XP1 + jam + XP2, në të cilën XP = sintagmë emërore.

Përgjithësisht pranohet se midis dy emrave që lidhen me foljen këpujë, i shquari është kryefjala dhe i pashquari kallëzuesi emëror (Sheperi, 1927:142; Çeliku, 2012:157). Sipas Sheperit, në rastet kur të dy emrat janë të shquar, për përcaktimin e kryefjalës nisemi nga rendi i tyre në fjali. I pari është kryefjalë, ndërsa ai që pason këpujën, kallëzues (1927:142). Një interpretim i tillë nuk është gjithmonë i mundshëm në rastin e fjalive këpujore. Kur këpuja lidh dy DP, jo në të gjitha rastet mund të flasim për përkimin e mësipërm. Le të krahasojmë:

(16) a. Atentatori i perandorit ishte Vasil Laçi.

b. Shkaku i dëmtimeve ishin reshjet e dëborës dhe ngricat.

Trajtimi i *Atentatori i perandorit* si kryefjalë në (16/a) kundërshtohet nga rasti (16/b), në të cilin vërehet se përshtatja e këpujës nuk bëhet me XP1 (*shkaku i dëmtimeve*), por me XP2 (*reshjet e dëborës dhe ngricat*), çka dëshmon se sintagma e dytë është kryefjala e fjalisë këpujore. Kjo do të thotë se, për rastin e gjuhës shqipe, ne nuk mund të mbështetemi në kriterin formal, treguesin e shquarsisë a rendin e fjalëve për të përcaktuar kryefjalën e kallëzuesin emëror. Për rastet kur kryefjala dhe kallëzuesi emëror nuk janë në të njëjtin numër, dallimi bëhet në bazë të përshtatjes së

² Për mospërputhjen midis qëndrimit të mbajtur në dy vëllimet e Gramatikës së Akademisë së Shkencave (*Morfologjia* dhe *Sintaksa*), në lidhje me kategoritë leksikogramatikore me të cilat shprehet kallëzuesi emëror, shih *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, 2002, f. 108-110; *Gramatika e gjuhës shqipe* 2, 2002, f. 241-248.

këpujës me kryefjalën. Si tregues më i plotë, i cili të mbulojë edhe rastet kur përshtatja nuk mund të shërbejë për një dallim të tillë, mund të shërbejë karakteri referencial i sintagmës emërore që del në rolin e kryefjalës. Kryefjala ka gjithmonë karakter referencial, ndërsa kallëzuesi emëror është joreferencial.


Por ndeshen edhe raste kur të dyja sintagmat, XP1 dhe XP2, kanë karakter referencial. Në një ndërtim të tillë mund të dalin dy emra të përveçëm, ose një përemër dëftor dhe një emër i përveçëm. Dëftori në këtë rast krijon lidhje me një referent të jashtëm, i përcaktueshëm nga situata e ligjërimin.

(17) a. Dhimitër Paskoja është Mitrush Kuteli.

b. Ky është Agimi.

Në këtë rast të dyja sintagmat lidhen me të njëjtin referent të jashtëm. Analiza e këtij tipi fjalish, të quajtura ekuacionale, mund të bëhet mbi bazën e ndarjes *temë — remë* dhe jo *kryefjalë — kallëzues*. E para del si temë, ndërsa e dyta si remë e fjalisë. Këpuja në këtë rast ka vlerën e një shenje barazimi. Pra, kemi: XP1 = XP2. Raporti i secilës sintagmë me këpujën identifikohet përmes përemrit pyetës *Kush* dhe jo *Kush / Çfarë* (*Kush është Dhimitër Paskoja? / Kush është Mitrush Kuteli?*). Kjo është dëshmi e barazisë funksionale që ato shfaqin në lidhje me këpujën.

Predikati i realizuar prej grupit emëror është një ndër temat e hapura të studimit dhe të argumentimit shkencor. Ndër dy prirjet kryesore: a) Trajtimi i kallëzuesit emëror sipas të njëjtit model strukturor sintaksor që shfaqin foljet e zakonshme (Dhima, 2010:125); b) trajtimi i kallëzuesit emëror si pjesë e një modeli të veçantë strukturor nga ai i foljeve të zakonshme; prirjen e dytë e mendojmë më të saktë dhe më të pranueshme edhe për rastin e gjuhës shqipe.




(18) Ai është shofer në port. (Xhaferi, 2010:185).

Skema e mësipërme është e interpretueshme sipas parashtrimit të Baker-it. Në nivelin *Pred'* ndodh ngjizja e bërthamës predikative të fjalisë, e cila përcakton specifikuesin në nivelin *PredP*. Grupi predikativ sillet sipër këtij niveli, në VP, si folje e zakonshme. Ndryshimi qëndron se specifikuksi, i cili del në rolin e kryefjalës, është përcaktuar që në nivelin *PredP* (*XPref*), pra poshtë nivelit VP, dhe jo sipër këtij të fundit, si në rastin e foljeve të plota.

Një interpretim i tillë i strukturës këpujore është i përshtatshëm për interpretimin e fjalive të zakonshme këpujore predikative, kur XP2 e ndjek drejtpërdrejt këpujën. Vështirësi dalin për interpretimin e ndërtimeve, në të cilat këpuja pasohet nga një ndajfolje me vlerë modifikuesi. Ndonëse pozicioni normal i saj në gjuhën shqipe është ai pas kallëzuesit, ndodh që ajo të dalë edhe në pozicion të ndërmjetëm, midis këpujës dhe pjesës emërore të kallëzuesit, si në rastin e mëposhtëm:

(19) a. Vajza është akoma fëmijë.

b. Vajza është fëmijë akoma.




Duke qenë se [V' është fëmijë] përbën kallëzuesin emëror, mbetet për t'u shpjeguar futja e modifikuesit [ADV akoma] në pozicionin midis foljes dhe pjesës emërore të kallëzuesit. Ky pozicion nuk mund të shpjegohet me rregullën e lëvizjes në fjali, brenda sintagmës funksionale PredP, pasi lëvizja ndodh gjithmonë nga e djathta në të majtë dhe nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë. Duke dalë në këtë pozicion ndajfolja modifikon predikatin dhe jo krejt fjalinë, gjë që ndodh në rast të pozicionit fundor të saj (19/b). Në (19/a) kemi një rast i cili mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, për shkak të ambiguitetit që mbart një ndërtim i tillë, si dhe për shkak të homonimisë që krijohet me foljen e plotë *jam*: *Vajza është akoma në shtëpi*. Dallimi mes këpujës dhe foljes së plotë është i rrokshëm, përmes mundësisë së zëvendësimit të saj prej foljes *ndodhem*, prandaj ky rast nuk do të trajtohet.

Një interpretim i parë i këtij ndërtimi mund të jetë ai, sipas të cilit, *akoma* modifikon këpujën *është* (19/a-1), duke e aktualizuar atë me çastin e ligjërimit. Modifikimi është i natyrës gramatikore. Folja këpujë karakterizohet nga kuptimi kohor i akronisë, i cili karakterizon përgjithësisht format e së tashmes së dëftores (*mbart, eci, dëgjoj* etj.). Për foljet e zakonshme ky lloj modifikimi, aktualizimi me çastin e ligjërimit, realizohet në dy rrugë të ndryshme: a) Përmes formës aktualizuese të tipit *po eci, po dëgjoj*; b) përmes pranisë së modifikuesve ndajfoljorë, *akoma, ende* etj. Për këpujën nuk ekziston një formë e tipit (a) *po jam*. Aktualizimi kryhet përmes pranisë së modifikuesit ndajfoljor. Modifikimi nuk prek semantikën e munguar të foljes *jam*. Nuk kemi prani të kuptimit të ekzistencës, e


vërtetueshme kjo nga pamundësia e përdorimit të *ndodhet*, *gjendet* në vend të *jam* në fjalinë përkatëse.

Një interpretim i dytë i (19/a-2) është pranimi i *akoma* si modifikues i [NP *fëmijë*], çka semantikisht do të ndikonte në interpretimin e fjalisë si *Vajza është e parritur*. Një përdorim i tillë është jo i zakonshëm për gjuhën shqipe, por jo dhe i pamundur. Në një interpretim të tillë *akoma* përafrohet me kuantifikatorë (Q) të tillë sasiore, si *pak*, *shumë*, *gati* etj. Kjo nuk e cenon statusin e kallëzuesit emëror, pasi si specifikues i NP, elementi *akoma* bëhet pjesë e natyrshme e kallëzuesit emëror.



Paraqitja e mësipërme grafike e strukturimit të të dy rasteve nuk është pa probleme. Nuk është e besueshme që modifikimi i këpujës të ndodhë në nivelin zero. Nëse pranohet kjo, atëherë struktura e fjalisë del identike me atë të fjalisë me folje të zakonshme. Sintagma PredP mund të zëvendësohet me VP. Kjo na çon në interpretimin e këpujës si folje e zakonshme, gjë që nuk përputhet me raportin predikativ mes XP1 dhe XP2. Sintagma bazë është [*vajza Pred fëmijë*] dhe prej saj përftohet sintagma [*VP është akoma fëmijë*]. Rikompozimi i sintagmës duhet të bëhet në një nivel mbi *PredP*. Një interpretim i mundshëm është paraqitur në skemën e mëposhtme, e cila është bazuar në analizën e Hazout (2004).

Na duhet të pranojmë se përmes *akoma* modifikohet krejt bërthama predikative dhe jo vetëm këpuja apo pjesa emërore e predikatit. Modifikimi nuk mund të ndodhë brenda sintagmës PredP, pasi funksioni i saj është krijimi i bërthamës predikative dhe përcaktimi i specifikuesit. Marrja e modifikuesit ndodh në një sintagmë më lart PredP, e pikërisht në VP. Ndajfolja *akoma* i bashkohet [v' është fëmijë} në të djathtë të saj në një nivel të dytë V' , e prej kësaj lëviz në të majtë të saj. Pozicioni paskëpujor realizohet me lëvizjet që ndodhin falë kalimit nga *PredP* në *IP*. Interpretimi semantik i kësaj skeme është ky: Ndajfolja *akoma* bëhet pjesë e strukturës këpujore si modifikues i krejt kallëzuesit emëror. Në gjuhën shqipe nuk ka ndonjë kufizim në lidhje me pozicionin e saj në fjali, e si rrjedhim ajo mund të dalë në pozicione të ndryshme pa ndryshuar semantikën e fjalisë. Pozicioni V' , në të cilin ajo bëhet pjesë e sintagmës VP, tregon qartë se ajo i bashkohet krejt grupit predikativ, të cilin e modifikon si të tillë, dhe jo vetëm një gjymtyrë të tij. Modifikimi i grupit emëror në nivelin zero, si pjesë e kallëzuesit emëror, është i mundshëm vetëm prej modifikuesve sasiore (Q), të cilët dalin në rolin *Spec* të sintagmës emërore: *pak/shumë/gati fëmijë*.





(21) a. Vajza është gati fëmijë.

Një çështje me interes është përqasja e organizimit strukturor të fjalive këpujore, në të cilat është i pranishëm kallëzuesi emëror, me atë të fjalive në të cilat është i pranishëm përcaktori kallëzuesor (A. Sh., 2002:241). Ndërsa kallëzuesi emëror lidhet me këpujën *jam*, përcaktori kallëzuesor lidhet me foljet e plota, të cilat shfaqen në ndërtime sintaksore të ngjashme me ato të këpujës. Identifikimi i këtyre foljeve si këpujore, ka çuar në përfundime të ndryshme: a) mosnjohjen e kallëzuesit emëror në të mirë të kallëzuesorit (Dhima, 2010:125); b) mosnjohjen e përcaktorit kallëzuesor në të mirë të kallëzuesit emëror (Çeliku, 2012:155); c) mosnjohjen e asnjërit (Memushaj, 2009:107). Një ndër argumentet për mospranimin e dy kategorive sintaksore të ndryshme, kallëzuesit emëror dhe përcaktorit kallëzuesor, është se midis ndërtimeve përkatëse nuk ka dallime, as strukturore, as kuptimore (Dhima, 2010:126). Ne nuk do të merremi me çështjet e debatueshme në lidhje me njërin qëndrim apo tjetrin. Ajo që për ne ka interes është argumentimi i një dallimi strukturor midis fjalive me bazë këpujën *jam* dhe atyre me bazë një folje të zakonshme, dallim i bazuar në karakteristikat e veçanta semantike e funksionale që paraqesin foljet përkatëse. Në shembujt e mëposhtëm ne do të analizojmë strukturat përkatëse për të arritur në një përfundim sa më bindës, duke marrë parasysh kriterin funksional dhe atë strukturor të këpujës. Janë pikërisht këto dy kritere që mund të identifikojnë një ose dy gjymtyrë të ndryshme për rrethana të caktuara sintaksore.

(22) a. Smira e një gruaje ishte dukuria më e njohur gjithkund.

b. Berati përfundoi i humbur.


c. Ata e lanë portën hapur.



Skema: 22/b

Skema: 22/a

Skema: 22/c



Nga parashtrimi i deritanishëm, si dhe nga përqasja e skemave përkatëse të fjalive në (22), mund të shprehemi se, sikundër në gjuhët e tjera ashtu edhe në rastin e gjuhës shqipe, struktura e fjalive këpujore nuk është e njëjtë me atë të fjalive që kanë për kallëzues një folje të zakonshme. Në rastin e fjalive këpujore kryefjala përcaktohet brenda sintagmës funksionale PredP, poshtë nivelit VP. Në rastin e fjalive me folje të zakonshme kryefjala përcaktohet në nivelin Pr (Bower, 1993), mbi sintagmën VP, pasi folja, e plotësuar me argumentet e saj të brendshme në VP, vetëm këtu del si predikat i aftë për të përcaktuar kryefjalën (Bower, 1993:597). Qartazi, kemi dy struktura të dallueshme prej njëra-tjetrës, struktura të cilat përfaqësojnë dy interpretime të ndryshme semantike.

Përfundimi i arritur në bazë të analizës sonë të strukturës semantike e sintaksore të ndërtimeve këpujore në gjuhën shqipe është në mbështetje të mendimit të shfaqur prej autorëve të tjerë në gjuhën shqipe, se si këpujë del vetëm folja *jam*. Foljet e tjera me "vlerë këpujore", ndonëse shfaqin tipare të këpujës dhe dalin në konstrukte formalisht të ngjashme me ato në të cilat është e pranishme këpuja *jam*, mbetet të trajtohen si folje të

zakonshme. Në një përfundim të tillë çon analiza e strukturës bazë të tyre, e cila dëshmon se janë ato që e përcaktojnë kryefjalën në nivelin PrP mbi VP, ndryshe nga rasti i këpujës *jam*, ku kryefjala përcaktohet prej kallëzuesit emëror në nivelin PredP, poshtë VP.

Ndryshimi më i rëndësishëm, më saktë ai që përbën thelbin e diskutimit, është se në rastin e foljes këpujë *jam* XP2 përcakton kryefjalën e fjalisë. Në rastin e foljeve të zakonshme, është folja ajo që kryen këtë funksion dhe jo plotësi i kryefjalës apo kundrinës. Ky kushtëzim i natyrës semantike e sintaksore u siguron status të ndryshëm sintaksor të dy grupeve emërore që dalin në lidhje dyfishe në këto fjali. Kjo do të thotë që roli i kallëzuesit emëror dhe ai i përcaktorit kallëzuesor janë të identifikueshëm si role të ndryshme funksionale e strukturore.

Në rolin e kallëzuesit emëror del gjithmonë një sintagmë emërore, e cila për shkak të veprimit të elipsës në kokën e saj, fizikisht përfaqësohet në shumicën e rasteve nga plotësi i vet, i cili mund të jetë mbiemër, emër në gjinore, kallëzore, rrjedhore ose paskajore.

Ndonëse struktura sipërfaqësore e fjalisë nuk lë vend për dallim midis përcaktorit kallëzuesor dhe kallëzuesit emëror, funksioni strukturor dhe tematik i tyre është i ndryshëm, në varësi të lidhjes me foljen *jam*, ose me foljet e zakonshme. Funksioni sintaksor i kallëzuesit emëror është përcaktimi i kryefjalës, funksion i mëvetësishëm i tij, i cili e dallon si gjymtyrë të ndryshme prej përcaktorit kallëzuesor.

BIBLIOGRAFI

- A. Sh. (2002/a). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002.
- A. Sh. (2002/b). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002.
- Baker, M C. (2003). *LexicalCategories. Verbs, NounsandAdjectives*. Cambridge: CambridgeUniversityPress.
- Bowers, J. (1993). *The SyntaxofPredication*. Në: *LinguisticInquiry*, Volume 24, Number 4, Fall 1993, f. 591-656.
- Cipo, K. (1952). *Sintaksa*. Tiranë.
- Çeliku, M. (2012). Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë). *ILAR*. Tiranë.
- Çeliku, M., Karapinjalli, M. &Stringa, R. (1998). *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. Toena, Tiranë.

- DenDikken, M. (2006). *Relators and Linkers. The Syntax of Predication, Predicate Inversion, and Copulas*. Cambridge, MA: The MIT Press.
- Domi, M. (1970). *Sintaksa për shkollat e mesme pedagogjike*. Tiranë.
- Dhima, Th. (2010). *Gjuha shqipe. Sintaksa*. Gjirokastër.
- Hazout, I. (2004). *The syntax of existential constructions*. *Linguistic Inquiry* 35, f. 393-430.
- Heggie, L. (1988). *The Syntax of Copular Structures*. Ph. D. thesis, USC.
- Heycock, C. & Kroch, A. (2002). *Topic, focus, and syntactic representations*. Në: L. Mikkelsen and C. Potts (Eds.), *Proceedings of WCCFL 21*, f. 101-125. Somerville, MA: Cascadia Press.
- Higgins, R. F. (1979). *The Pseudo-cleft Construction in English*. New York: Garland.
- Koleci, F. & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të gjuhës shqipe*. SHBLU, Tiranë.
- Lohndal, T. (2006). *The Phrase structure of the copula*. Në: *Working Papers in Scandinavian Syntax* 78, f. 37-75.
- Memushaj, R. (2009). *Bukuria e gjuhës*, 3, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë.
- Mikkelsen, L. (2005). *Copular Clauses: Specification, predication and equation*. Amsterdam: John Benjamins.
- Mikkelsen, L. (2006). *Specification of copular clauses*. Në: http://linguistics.berkeley.edu/mikkelsen/talks/Shoin_ho.pdf
- Mikkelsen, L. (2011). *Copular Clauses*. Në: Klaus von Stechow, Claudia Maienborn and Paul Portner (eds.), *Semantics: An International Handbook of Natural Language Meaning*, volume 33.2 of *Handbuch der Sprach- und Kommunikationswissenschaft*, Chapter 68, f. 1805-1829, Berlin: Mouton de Gruyter.
- http://linguistics.berkeley.edu/mikkelsen/papers/mikkelsen_copular_clauses_web.pdf, 07.10.2012.
- Partee, B. (1987). *Noun Phrase and Type-Shifting Principles*. In: Groenendijk et al. (eds), *Studies in Discourse Representation Theory and the Theory of Generalized Quantifiers*. Dordrecht, f. 115-143.
- Përnaska, R. (1973). *Gramatika e gjuhës shqipe (për shkollën e mesme pedagogjike)*. Tiranë.

- Prifti, S. (1986). *Elipsa në sintaksën shqipe*. Në: *Studime Filologjike*, 1986/3, Tiranë.
- Prifti, S. (1963). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Rothstein, S. (2001). *Predicates and their Subjects*. Dordrecht: Kluwer.
- Rrota, J. (1941). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Shkodër.
- Stassen, L. (1997). *Intransitive Predication*. Oxford University Press Inc., New York.
- Sheperi, I D. (1927). Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe (sidomos e toskënishtes). *Vlorë. Ribotuar në Romë, 1972.*
- Totoni, M. (1976). *Përcaktori kallëzuesor*. Në: *Studime filologjike*, 1976/3, Tiranë.
- Totoni, M. (1978). *Kallëzuesi në shqipen e sotme letrare*. Në: *Studime filologjike*, 1978/1, Tiranë.

REGARDING TO “COPULA” AND PREDICATE NOMINATIVE IN ALBANIAN LANGUAGE

Summary

The object of this article is to give an evidence and interpretation of copula constructions in Albanian language and to focus on its contribution to syntactic and semantic relations in the frame of copular sentences. Copula has been object of previous syntactic analyses, focused on the interpretation of nominal predicate in Albanian linguistics. There are two distinct interpretation of the nominal group related to copula in Albanian language: a) as predicate nominal; b) as complement. To give a more acceptable and mature decision on this topic, we take in consideration the semantic status of copula and its organizing role inside the predicate nominal. Under the generative grammar principles, we will analyse the copula constructions and will argue, based on the clear evidences, that it is more reasonable to interpret the nominal group, being the head of the verbal phrase, as predicate nominal.